



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.Sh II.nr.1009/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri në çështjen përmbartimore të kreditorit Komuna e Prishtinës me seli në Prishtinë, kundër debitorit Viva Fresh Sh.p.k, me nr. unik identifikues 810670390, me adresë në Suhadoll, Magjistratja Prishtinë-Lipjan, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës- Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.905/22 të datës 30.05.2023, me datë 12.12.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit Komuna e Prishtinës, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.905/22 të datës 30.05.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale te Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.905/22 të datës 30.05.2023, në pikën I të dispozitivit e ka pranuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit Viva Fresh Sh.p.k, të ushtruar kundër Urdhrit për Përmbartim P.nr.1277/22 të dt. 23.09.2021 të Përmbartuesit Privat Isa Gacaferri.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës përmbartimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale me propozim që gjykata e shkallës së dytë, aktvendimin e ankimuar ta ndryshoj dhe çështjen ta kthej në shkallë të parë ne rivendosje.

Debitori nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaremore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Komuna e Prishtinës me datën 22.09.2021, ka paraqitur propozimin për përmbaremore në bazë të dokumentit Urdhëresë për pagesë të ndëshkimit me gjobë mandatore me nr. 000129/18 të datës 30.07.2019 duke detyruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të Urdhrit, t'ia paguajnë kreditorit shumën prej 630.00 (gjashtëqind e tridhjetë euro) me kamatë vonesë prej 8% nga arritja për pagesë e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës përmbaremore.

Përmbareuesi Privat Isa Gacaferri me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbaremore të kreditorit me urdhrin përmbaremore P.nr.1277/21, dt.23.09.2021 e ka lejuar përmbaremoren e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin përmbaremore me arsyetimin se kemi të bëjmë me një të drejtë të parashkruar të kreditorit, për faktin se urdhri për përmbaremore është nxjerrë dy (2) vite e dy (2) muaj pas shqiptimit të gjobës mandatore për kryerje të kundërvajtjes dhe në kuptim të nenit 43 të Ligjit mbi Kundërvajtje, sanksioni i shqiptuar kundërvajtës nuk mund të ekzekutohet nëse nga data kur vendimi mbi kundërvajtjen ka marrë formën e prerë, kanë kaluar mbi një (1) vit, ndërsa në rastin konkret afati i parashkrimit të ekzekutimit ka kaluar dyfish. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet si i bazuar prapësimi dhe të shfuqizohet urdhri përmbaremore.

Përgjigje në prapësim ka parashtruar kreditori duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit me arsyetimin se për gjatë kohës sa kreditori ka pasur të drejtë të kërkojë ekzekutimin e gjobës, në vend kanë ekzistuar masat kufizuese për shkak të pandemisë Covid-19, andaj kreditori ka qenë i detyruar të punoj me shërbime esenciale Me kërkesë që prapësimi të refuzohet ndërsa Urdhri Përmbaremore P.nr. 1277/21 i datës 23.09.2021 të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale te Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.905/22 të datës 30.05.2023, në pikën I të dispozitivit e ka pranuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit Viva Fresh Sh.p.k, të ushtruar kundër Urdhrit për Përmbarim P.nr.1277/22 të dt. 23.09.2021 të Përmbaruesit Privat Isa Gacaferri.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata ka theksuar se dokumenti i lartcekur nuk përmban atributet e një vendimi të organit administrativ i cili mund të këtë cilësinë e dokumentit përmbarues sipas nenit 23 par. 2 të LPP-së.

Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale, dhoma e shkallës së dytë pas analizimit të shkresave të lëndës vërejtë se dokumenti mbi bazën e së cilave është lejuar përmbarimi nuk paraqet titull ekzekutiv ashtu siç kërkohet me nenin 23 par.2 të LPP-së *“Vendim i organit administrativ, sipas këtij ligji konsiderohet vendimi dhe konkluzioni i dhënë në procedurë administrative nga organi ose shërbimi administrativ apo nga personi juridik i ngarkuar me autorizime publike, kurse akt pajtim administrative konsiderohet ujdia e arritur në procedurën administrative përpara organit ose shërbimit, përkatësisht personit juridik të tillë, po qe se ka të bëjë me detyrimin në të holla dhe po qe se me ligj nuk është paraparë diçka tjetër”*. Ndërsa me nenin 24 të LPP-së është përcaktuar se *“Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë”*.

Andaj, duke u bazuar në dispozitat e lartcekura, dokumenti Urdhëresë për pagesë të ndëshkimit me gjobë mandatore me nr. 000129/18 të datës 30.07.2019 nuk mund të konsiderohet si dokument

i besueshëm e as titull ekzekutiv, nuk përmban atributet e një vendimi të organit administrativ në kuptim të dispozitave të lartcekura, andaj për këtë arsye vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Dhoma e shkallës së dytë i vlerësoi të gjitha pretendimet e tjera ankimore por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendim, mirëpo kreditori mund të inicoj procedurë tjetër gjyqësore lidhur me realizimin e kërkesës së tij varësisht sipas suksesit në at procedurë. Nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e kreditorit si e pathemeltë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-DHOMA E SHKALLËS SË DYTË

K.Dh.SH.nr.1009/23, me datë 12.12.2023

Gjyqtarja,
Franciska Zhitija-Ymeri